KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi, 2020 - 2023

23.02.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksi i Çmimeve të Inputeve Bujqësore për vitet 2020- 2023.

Rritje e lehtë e indeksit të përgjithshëm të çmimeve të inputeve në bujqësi në vitin 2023

Ky publikim është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinare, në kompani , tregje dhe vende të tjera, ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion.

Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve për vitet 2020 – 2023, (2020= 100)



Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të inputeve në bujqësi në %

Në vitin 2023, indeksi vjetor i çmimeve të inputeve në bujqësi ka rënie për (-7,0%) për Input 1, krahasuar me vitin 2022. Ndërkaq, indeksi i çmimeve për Input 2 ka rritje për 11,0%. Kurse, indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 +Input 2) në vitin 2023 ka rritje për 0,6%, krahasuar me vitin 2022.

Ndryshimi ndërmjet vitit 2023 me vitin 2022 në %

Përshkrimi	2022	2023	Ndryshimi në %
Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (INPUT 1)	148,1	137,6	-7,0
Mallrat dhe shërbimet që kontribojnë investimet bujqësore (INPUT 2)	138,7	153,9	11,0
Inputi I përgjithshëm (INPUT1 + INPUT 2)	144,0	144,8	0,6

Ndryshimi vjetor i indeksit në vitin 2023, krahasuar me vitin 2020 në %

Në vitin 2023, indeksi vjetor i çmimeve të inputeve në bujqësi ka rritje për 37,6% për Input 1 dhe 53,9% për Input 2 në vitin 2023, krahasuar me vitin 2020.

Indeksi vjetor i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rritje për 44,8% në vitin 2023, krahasuar me vitin 2020.

Ndryshimi në% viti 2023 me vitin 2020

Përshkrimi	2020	2023	Ndryshimi në %
Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (INPUT 1)	100,0	137,6	37,6
Mallrat dhe shërbimet që kontribojnë investimet bujqësore (INPUT 2)	100,0	153,9	53,9
Inputi I përgjithshëm (INPUT1 + INPUT 2)	100,0	144,8	44,8

Produktet që përbëjnë bazën për Indeksin e çmimit të inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të Mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbështues dhe energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinari, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbimet e tjera.

Sa i përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje të tjera), ndërtesa dhe të tjera (ndërtesat jo-rezidente të fermës, punët e tjera përveç përmirësimit të tokës).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Për më shumë informata lidhur me Indeksin e Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi, 2020 – 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Agriculture